



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 162 , Datë 29.10.2019

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË HEC “LASHKIZA” SH.P.K., PËR LËNIEN NË HIPOTEKË DHE
BARRË TË ASETVE NË FAVOR TË BANKËS “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA”
SH.A..**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika “1”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 të “Kushteve të Licencës” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, gjithashtu dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” dhe pika 3 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/3 Prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC Lashkiza” sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 591 Prot, datë 25.09.2019, shoqëria “HEC LASHKIZA” sh.p.k., ka kërkuar lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve që disponon shoqëria HEC LASHKIZA sh.p.k., në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të marrjes së një kredie për financimin e ndërtimit të projektit të shoqërisë HEC LASHKIZA sh.p.k.
- Kjo shoqëri, është krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1 të Kontratës Koncesionare, Nr. 8300 Rep., Nr. 2954 Kol, datë 27.06.2012, “Për ndërtimin me Koncesion të formës BOT, të HEC-eve: “Lashkiza 1”, “Lashkiza 2” dhe “Lashkiza 3”, të lidhur ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive “Spartaku” sh.p.k., dhe “ERPA INVEST” sh.p.k me cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, në zbatim të VKM-së Nr. 537, datë 27.07.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC-eve “Lashkiza 1”, “Lashkiza 2” dhe “Lashkiza 3”.
- Shoqëria “HEC LASHKIZA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 337, Seria PV16K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 41, datë 12.04.2016, për një periudhë 30 vjeçare dhe e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 338, Seria T15, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 42, datë 12.04.2016.

Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në *Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit* si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “d”, “h”, janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 7 pika 1 gërma “c”, (gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve). Plotësuar pjesërisht.
- Neni 7 pika 1 gërma “e”, (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit). Plotësuar pjesërisht.
- Nga të dhënat që disponon ERE nga raportimi i OSHEE sh.a dhe OST sh.a, rezulton se HEC-et: “Lashkiza 1” dhe “Lashkiza 2”, janë në operim, dhe janë të lidhur në nivelin e tensionit 110 kV. Për vitin 2019 respektivisht kanë prodhuar energji për të gjithë muajt. Sa më sipër për HEC-in “Lashkiza 3”, nuk rezulton që shoqëria të jetë e licencuar, dhe nuk ka të dhëna lidhur me ndërtimin e tij.
- Neni 7 pika 1 gërma “f”, (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit). Pa plotësuar.
- Neni 7 pika 1 gërma “g”, (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licensuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licensuar). Pa plotësuar.
- Neni 7 pika 1 gërma “i”, (Deklaratë me shkrim e personit (Subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licensuar pas kryerjes së transferimit). Pa plotësuar.
- Neni 7, pika 1, gërma “j”, (Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt). Pa plotësuar.
- Neni 7 pika 3, (Subjektet koncensionare të licensuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve). Plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC LASHKIZA” sh.p.k., për lënie në hipotekë dhe barrë të asetëve të shoqërisë, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a..
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI